



PËRMIRËSIMI I BASHKËPUNIMIT BULETINI

IPA Programeve të Bashkëpunimit
ndërkufitar Mal i Zi - Shqipëri dhe
Mal i Zi - Kosovë 2014- 2020

Maj
2021

FOTO: ZHVILLIMI I EKO-TURIZMIT NË ALPET BALLKANIKE (QENDRA PËR MBROJTJEN DHE HULUMTIMIN E ZOGJVE – MAL I ZI/YOUTUBE)

PËRMBAJTJA

Edicioni i dhjetë i buletinit ju sjell informacione mbi aktivitetet e zbatuara në kuadër të dy programeve IPA BNK Mal i Zi – Shqipëri dhe Mal i Zi - Kosovë* 2014-2020.

Më shumë informacione për programet mund të gjeni më poshtë.

Programi IPA BNK Mal i Zi - Shqipëri 2014-2020

Qëllimi i përgjithshëm i programit është të promovojë dhe të forcojë marrëdhëniet e mira fqinjësore dhe zhvillimin socioekonomik të rajoneve kufitare, përmes valorizimit të potencialeve turistike dhe një zhvillimi ekonomik, social dhe mjedisorë të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës, në respekt të trashëgimisë së përbashkët kulturore dhe natyrore.

Klikoni [këtu](#) për më shumë informacione.

Programi IPA BNK Mal i Zi- Kosovë 2014-2020

Qëllimi i përgjithshëm i programit është të përmirësojë standardet dhe cilësinë e jetës së njerëzve në zonën e programit nëpërmjet zhvillimit ekonomik, social dhe mjedisorë të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës të rajonit në respekt të trashëgimisë së përbashkët kulturore dhe natyrore.

Klikoni [këtu](#) për më shumë informacione.

| | |
|--|----|
| »»» Shpallet Thirja e Tretë për projekt propozime brenda Programit IPA për Bashkëpunim Ndërkufitar Mali i Zi-Kosovë 2014-2020..... | 2 |
| »»» Te reja nga projektet e financuara në thirrjen e I-rë të programit IPA BNK Mal i Zi – Shqipëri..... | 3 |
| »»» Të reja nga projektet e financuara në thirrjen e I-rë të programit IPA BNK Mal i Zi – Kosovë..... | 5 |
| »»» Te reja nga projektet e financuara në thirrjen e II-rë të programit IPA BNK Mal i Zi – Shqipëri | 6 |
| »»» Te reja nga projektet e financuara në thirrjen e II-rë të programit IPA BNK Mal i Zi – Kosovë | 9 |
| »»» Ceremonia solemne me rastin e fillimit të zbatimit të projekteve të kontraktuara nga Thirrja e dytë | 11 |
| »»» Mbahen takimet dypalëshe për të dy programet..... | 12 |
| »»» Është mbajtur mbledhja e parë e Komitetit Drejtues të Projektit për projektin e ri të asistencës teknike..... | 12 |
| »»» Aktivitetet për rritjen e kapaciteteve për Aplikuesit Potencial dhe Përfituesit e Projekteve..... | 12 |
| »»» Programi IPA BNK Mali i Zi - Shqipëri mori pjesë në Forumin EUSAIR..... | 13 |
| »»» Mbahet ceremonia e hapjes së Shtëpisë për Bashkëpunim Ndërkufitar..... | 14 |

Ky publikim është prodhim i mbështetjes financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e saj është përgjegjësi e Sekretariatit të Përbashkët Teknik të Programeve IPA BNK Mali i Zi – Shqipëri dhe Mali i Zi – Kosovë 2014-2020 dhe nuk paraqet domodoshmerisht mendimet e Bashkimit Evropian.

* Ky shënim është pa paragjykim të pozicioneve për status dhe është në linjë me RKS KB 1244 dhe Opinionin e GJND-së për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.



Ky projekt është i financuar nga Bashkimi Evropian



MNE – ALB

IPA PROGRAMI I BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR
MALI I ZI – SHQIPËRI 2014-2020



MNE – KOS

IPA PROGRAMI I BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR
MALI I ZI – KOSOVË 2014-2020



Shpallet Thirja e Tretë për projekt propozime brenda Programit IPA për Bashkëpunim Ndërkufitar Mali i Zi-Kosovë 2014-2020

Qeveria e Malit të Zi – Zyra për Integritim Evropian dhe Drejtoria e Financës dhe Kontraktimit për Asistencën e Fondeve të BE-së në Ministrinë e Financave dhe Mirëqenies Sociale të Malit të Zi, në bashkëpunim me Ministrinë e Pushtetit Lokal të Republikës së Kosovës ju ftojnë të përdorni fondet e BE-së dhe të aplikoni për projekte të përbashkëta nën Thirrjen e Tretë për projekt propozime në kuadër të Programit IPA për Bashkëpunim Ndërkufitar Mali i Zi-Kosovë 2014-2020.



Qëllimi i përgjithshëm i kësaj thirrje është të përmirësojë standartet dhe cilësinë e jetës së njerëzve në zonën e programit nëpërmjet një zhvillimi ekonomik, social dhe mjedisor të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës të rajonit në respekt të trashigimisë së përbashkët kulturore dhe natyrore.

Fondet në vlerë prej 3.48 milion EUR janë në dispozicion nën këtë thirrje dhe janë të përkushtuar për prioritetet tematike në vijim (PT):

- PT1: Promovimi i punësimit, lëvizshmëria e krahut/ofertës së punës dhe përfshirjes kulturore dhe sociale përmes kufirit;
- PT2: Mbrojtja e Mjedisit, promovimi i ndryshimeve klimatike dhe masave për zbutjen e tij, menaxhimi dhe parandalimi i rreziqeve;
- PT3: Inkurajimi i Turizmit, Kulturës dhe Trashigimisë Natyrore;

Thirrja është e hapur për persona juridikë dhe organizata jofitimprurëse të themeluara në Mal të Zi dhe Kosovë dhe që u përkasin kategorive të mëposhtme: qeveritë lokale dhe institucionet e tyre, shoqatat e komunave, agjencitë e zhvillimit, organizatat lokale të mbështetjes së biznesit, organizatat e turizmit dhe kulturës, OJQ-të, organet private dhe publike që mbështesin fuqinë punëtore, institucionet e trajnimit profesional dhe teknik, organet dhe organizata për mbrojtjen e natyrës, organet publike përgjegjëse për menaxhimin e ujit, shërbimet e zjarfikëseve/emergjencës, shkollat, kolegjet, universitetet dhe qendrat kërkimore, duke përfshirë institucionet për trajnim profesional dhe teknik.



Afati i fundit për dorëzimin e projekt propozimeve është data **25 qershor 2021**.

Më shumë informacion mbi Thirrjen për Propozime mund të gjeni [këtu](#).

Publikimi i Thirrjes për Propozime u promovua gjerësisht përmes mediave sociale dhe tradicionale.

Sesion informative online për Thirrje të 3-të

Pas publikimit të Thirrjes së 3-të për projekt propozime në kuadër të Programit IPA për Bashkëpunim Ndërkufitar Mali i Zi-Kosovë



2014-2020, më 25 maj 2021 u organizua një online sesion Informativ, që synonte prezantimin e rregullave të Thirrjes së Tretë për Propozime.

Më shumë se 100 përfaqësues të aktorëve të ndryshëm nga zona ndërkufitare patën mundësinë të informohen mbi qëllimet e programit dhe prioritetet tematike, alokimin financiar të siguruar, përshtatshmërinë e aplikantëve, aktivitetet e pranueshme, përshtatshmërinë e kostove: kostot që mund të përfshihen dhe si të aplikojnë dhe procedurat që duhet të ndjekin.



Pyetjet dhe përgjigjet nga sesioni informativ si dhe nga pyetjet e marra përmes postës zyrtare do të publikohen [këtu](#).

Përdorni Instrumentin e Kërkimit të Partnerëve për të gjetur partnerin tuaj të ardhshëm në projekt

Jeni duke kërkuar partner për një projekt të ri në kuadër të programit IPA BNK Mal i Zi – Shqipëri ose programit IPA BNK Mal i Zi – Kosovë 2014-2020? Instrumenti ynë për kërkimin e partnerëve është i disponueshëm t'ju asistojë për gjetjen e partnerëve. Ju lutemi që të plotësoni formularin e kërkimit të partnerit dhe publikoni informacionin në bazën tonë të të dhënave në mënyrë partnerët e tjerë të interesuar të kenë mundësinë të ju kontaktojnë.

Klikoni [këtu](#) për qasje tek instrumenti për programin IPA BNK Mal i Zi – Shqipëri 2014 - 2020.

Klikoni [këtu](#) për qasje tek instrumenti për programin IPA BNK Mal i Zi -Kosovë 2014-2020.

Te reja nga projektet e financuara në thirrjen e I-rë të programit IPA BNK Mal i Zi - Shqipëri

Përfundoi projekti *Fatkeqësitë natyrore nuk njohin kufinj*

Projekti *Fatkeqësitë natyrore nuk njohin kufinj* i ka përfunduar aktivitetet e tij. Një nga aktivitetet e fundit të zbatuara ishte mbështetja për Shërbimin Meteorologjik. Si pjesë e zbatimit të projektit, Prefektura Shkodër, mbështeti Shërbimin Meteorologjik Ushtarak me pajisje të reja meteorologjike dhe me "Sistemin për Njoftim të Hershëm". Sot Shërbimi Meteorologjik në Shkodër numëron dy stacione sinoptike, të instaluar në stacionin rajonal të Grudës, në Shkodër dhe në atë të Gjadrit në Lezhë, dhe dy hidro stacione të instaluar në lumin Buna dhe Drin, duke siguruar kështu mbulim të rajonit verior të Shqipërisë.

Falë pajisjeve teknologjike, stacionet mund të transmetojnë të dhënat e mbledhura nga programet e tyre në kohë reale, duke mundësuar parashikimin e motit në kohë të shkurtër, të mesme dhe të gjatë nga meteorologjistët.



Konferenca përmbyllëse e projektit *"Turizëm miqësorë për Fëmijët në rajonin ndërkufitarë"* u mbajt në Podgoricë

Konferenca përmbyllëse e projektit *Turizëm miqësorë për Fëmijët në rajonin ndërkufitarë* u mbajt me datë 22 dhe 23 prill në Podgoricë. Në këtë konferencë morën pjesë mbi 100 persona nga Mali i Zi dhe Shqipëria. Pjesëmarrësit ishin nga sektori privat dhe publik, më së shumti nga industria e turizmit dhe institucione qeveritare që punojnë në mbështetje të industrisë së turizmit dhe strategjisë për zhvillimin e tij.

Konferenca u çel nga **Ivana Gjuroviq**, Sekretare Shteti në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik. Ajo theksoi rëndësinë e projektit dhe gadishmërinë e Ministrisë për Zhvillim Ekonomik për këtë çështje. Menaxheri i komunës së Podgoricës, **Marjan Junçaj**, foli për rolin e

kryeqytetit si partner dhe për projektet me të cilat po merret kryeqyteti, siç janë ndërtimi i parqeve për lojra, peisazhit dhe aktivitete të tjera.

Drejtuësja e ADP-Zid, **Sanda Rakoçeviq**, vlerësoi se projekti i ka arritur objektivat e vendosura, të cilat ishin të kontribuonin në tërheqjen e turistëve familjarë me fëmijë në rajonin ndërkufitarë.

Përmes projektit u krijua një markë e re – "Miqësorë për Fëmijë". Marka është e mbrojtur si autentike malazeze. Në Malin e Zi, 50 ambiente për shërbime turistike janë markuar me markën – "Miqësorë për Fëmijë". Marka është gjithashtu e përfaqësuar edhe në bregdetin Shqipëtarë me 10 hotele në rajonin Shkodër dhe Lezhë të cilët janë markuar si "Miqësorë për Fëmijë".



Gjatë konferencës u prezantuan standardet e "Turizmit Miqësorë për Fëmijë" që tashmë aplikohen në 60 hotele/restorante/kafe në Malntë Zi dhe Shqipëri. Përmes projekti u krijuan standardet bazike dhe premium dhe tani është në detyrën e hoteleve të përcaktojnë cilin standard do aplikojnë.



Përveç audiencës në sallë kishte edhe shumë pjesëmarrës online, kryesisht ekspertë në fushën e turizmit. **Z Erzhen** nga Slloveni prezantoi konceptin e Turizmit 4.0 në emër të *Arctur.si*, sipas të cilit turistët orientohen të frekuentojnë destinacionet më pak të vizituara në Slloveni duke përdorur tokenizimin. Ata gjithashtu analizojnë kërkimet e ofertës turistike në Slloveni ku konsiderojnë vendet që frekuentojnë turistët dhe si mund të diversifikohet kjo hartë. **Josipa Bençek** në emër të organizatës Kutin oprezantoi aplikacionin AR, i cili ka si qëllim kryesor edukimin e fëmijëve në natyrë. Ky aplikacion është dizenuar t'i ofrojë fëmijëve tablete gjatë kohës që ata qëndrojnë në natyrë dhe kur kanë kontakt me kafshë të ndryshme i skanojnë dhe marrin informacione për to. Organizata Kutin ofron gjithashtu paketa trajnimi në hotele, në vend të dhomave të lojrave ku fëmijët kalojnë kohën zakonisht. **Z Abderrahim Kassou** nga Maroku shrytëzoi mundësinë për të prezantuar aktivitetet aktuale sa i përket përdorimit të inovacionit dhe kreativitetit në promovimin dhe ruajtjen e vlerave të kulturës dhe trashigimisë tradicionale të vendit të tij. Ai ndau me audiencën shembuj të modifikimeve dhe rregullimeve më të fundit në lidhje me komunikimin e potencialeve turistike grupeve të ndryshme (të rinjve, ekspertëve, turistëve që kërkojnë pushime aktive etj) dhe valorizimit të lokaliteteve konkrete. Në sesionin e fundit të ditës së pare kishte gjithashtu biseda mbi COVID dhe periudhën post-COVID. **Maurizio Davlio** nga Italia foli mbi turizmin në Itali, trendin e turizmit në atë vend

si dhe ndikimin që ka COVID në industrinë e turizmit të një vendi që frekuentohet nga turistë gjatë gjithë vitit. **Hjortur Smarason** në emër të "TO Visit Greenland" tha që ata po ballafaqohen me shumë vështirësi dhe që mbyllja prej shumë muajsh po i pengon ato të organizojnë aktivitetet e planifikuara. **Mirjana Ivanusha, MA**, prezantoi konceptin e kuponave në Slloveni të cilët ishin shpërndarë për të gjithë qytetarët dhe ishin përdorur proporcionalisht. Kushti ishte që kuponat të përdreshin deri në fund të vitit 2021 dhe vetëm për ofertat B&B, duke bërë kështu që të kishte një numër të madh ofertash për qytetarët.



Libri i kuzhinës "Gorska trpeza" ka hyrë në finale në përzgjedhjen e publikimit më të mirë të kulinarisë në botë

Libri i kuzhinës "Gorska trpeza" prodhuar në kuadër të projektit *Kuzhina lokale si ofertë turistike në rajonin ndërkufitarë* është kualifikuar për fazën finale për përzgjedhjen e publikimit të kulinarisë më të mirë në botë, në dy kategori – kategoria më e rëndësishme "Më i miri ndër më të mirët" dhe në kategorinë "Turizmi Gastronomik"! Pavarësisht pengesave që solli pandemia dhe konkurrencës së madhe, ky botim hyri në listën e finalistëve dhe mori të drejtën të përdorë çertifikatën "Më i miri në botë". Nga ana e Agjencisë për Zvillimin Rajonal BKP, deklaruan që: - Jo vetëm që kjo është shumë e rëndësishme për ne që kemi bërë maksimumin ta bëjmë me këtë publikim preanzantimin real të kulturës dhe traditës sonë reflektuar tek gastronomia jonë, por kjo është edhe hera e parë që një publikim kulinarie nga Mali i Zi hyn në finale të këtij kompeticioni prestigjioz, duke na bërë ne dyfish krenar dhe të lumtur. Ata falenderuan përfituesit e projektit; - të dashura gra tonat nga veriu, faleminderit që n'a ndihmuat të mbledhim recetat dhe historitë, sigurisht faleminderit gjithë ekipit që punoi për librin e kuzhinës dhe veçanërisht donatorit që bëri të mundur për ne të bëjmë këtë.



Sigurohuni të gjeni më shumë info mbi projektin dhe vizitoni faqen <http://www.gastro-puka.com/en> dhe <http://montegastro.me/>.

Vazhdojnë aktivitetet konservuese për kishën 1500 vjeçare në Hot të Malësisë së Madhe (Shqipëri)

Projekti *Rritja e bashkëpunimit - Nga antikitetet Kristiane drejt përmirësimit të Turizmit* ka vijuar me rezultate cilësore në rajonin

ndërkufitarë. Më saktë, ritmi i aktiviteteve të gërmimit dhe konservimit është ngadalësuar për shkak të situatës së pandemisë COVID-19 por kanë vijuar në tre-mujorin e parë të vitit 2021.



E veçanta e kësaj kisha janë gurët simbolikë që janë përdorur para 15 shekujsh dhe fakti se kjo kishë është ndër më të hershmet në Shqipëri dhe në të gjithë territorin e Ballkanit.



Të reja nga projektet e financuara në thirrjen e I-rë të programit IPA BNK Mal i Zi - Kosovë

Zhvillimi i eko-turizmit në Alpet Ballkanike

Projekti *Zhvillimi i eko-turizmit në Alpet Ballkanike* zbatohet nga Qendra për Mbrojtjen dhe Hulmimin e Zogjve, Qendra Kosovare për Avokim dhe Zhvillim (KADC), Shërbimi i shpëtimit malor të Malit të Zi dhe Shoqëria Bjeshkatore Alpiniste "Pashtriku". Në kuadër të projektit, është publikuar edhe një video plotësuese që promovon rajonin e Bashkëpunimit ndërkufitar.




Shikoni videon promovuese [këtu](#).

Për më tepër, u krijua gjithashtu një itinerar shtatë-ditor, për të gjithë ata që duan të zbulojnë në një mënyrë unike disa nga sekretet më të ruajtura të zonës ndërkufitare midis Malit të Zi dhe Kosovës. Për më shumë informacion klikoni [këtu](#).



Grebajë valley. Photo credit: Igor Stojović

Brenda të njëjtit projekt një ekran interaktiv u vendos para Organizatës Turistike të Gucisë si dhe përpara Organizatës Turistike të Deçanit. Shfaqja do të lehtësojë turistëve të marri informacione kryesore mbi me këtë zone .



Për më tepër, si rezultat i projektit, është hapur edhe uebsajti i turizmit në Deçan <http://decanitourism.org>.



i2 Qendrat vazhdojnë me rezultate në Pejë dhe Podgoricë

Në kuadër të projektit *Vetëpunësimi i të rinjve dhe ndërmarrësia sociale* që është zbatuar nga Asociacioni për Prosperitet Demokratik ZID (Mal i Zi), OJQ Lens, Kosovë, Qendra Liberale Demokratike dhe Qendër për aftësi kreativ janë hapur dy i2 Qendra. Gjegjësisht, në hapësirat janë realizuar një sërë aktiviteteve për ndërtimin e kapaciteteve. Shikoni video materijalin nga dy qendrat:

Kliko [këtu](#) për I2 Space Peja

Kliko [këtu](#) për I2 Space Podgorica



Punë të gjelbra në sektorin bujqësor për një të ardhme më të mirë të rajonit ndërkufitar të Malit të Zi dhe Kosovës

Si pjesë e aktiviteteve të projektit të *Punëve të Gjelbërta për një të ardhme më të mirë të rajonit ndërkufitar të Malit të Zi dhe Kosovës të*

zbatuar nga Komuna Andrijevica, OJQ Grupi Lokal i Veprimt Gjeravica dhe Unioni i Fermerëve të Veriut Malit të Zi, u krijua dhe u pajis një Qendër Trajnimi Deçan. Qendra e trajnimit do të përdoret për forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve teknike të fermerëve dhe palëve të tjera të interesit në bujqësi.

Sa i përket qëndrueshmërisë së projektit, Unioni i Fermerëve u krijua në Deçan duke mbledhur 26 fermerë që ishin pjesë e aktiviteteve të projektit. Qendra e trajnimit transferohet nën kujdesin e Komunës së Deçanit - Drejtorisë për Bujqësi, i cili është gjithashtu përgjegjës për mirëmbajtjen e pajisjeve të prokuruarra përmes projektit. Për më tepër, komuna e Deçanit ka ndarë fonde nga buxheti për mbështetjen e fermerëve të trajnuar në të ardhmen.



Të bashkuar kundër ndotjes

Komuna e Gjakovës në bashkëpunim me OJQ Let's Do It Peja në Kosovë dhe Komunën e Petnjicës dhe Qendrën për Zhvillim Rajonal - Rožaje në Mal të Zi përfunduan zbatimin e projektit *Të Bashkuar Kundër Ndotjes – UAP* që përfshin banorët që jetojnë pranë deponive ilegale, autoritetet komunale, punonjës në menaxhimin e mbeturinave dhe studentët nga komunat e Gjakovës dhe Petnjicës. Një nga aktivitetet e fundit të projektit ishte hapja e oborrit të riciklimit në Gjakovë.



Në ceremoninë e inaugurimit morën pjesë Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, **Elbert Krasniqi**, dhe Kryetari i Komunës së Gjakovës, **Ardian Gjini**, të cilët vlerësuan projektin, duke deklaruar se si institucionet lokale ashtu edhe ato qendrore janë të angazhuara që të vazhdojnë të mbështesin këtë qendër dhe të përmirësojnë situatën e menaxhimit të mbeturinave në komunën e Gjakovës.

Videoja nga ceremonia e hapjes mund të shikohet [këtu](#).

Përfundoi projekti CARES

Projekti CARES - Veprimt ndërkufitare në sektorin e shëndetit riprodhues është finalizuar në shkurt të vitit 2021 pas dorëzimit të pajisjeve shtesë qendrave shëndetësore. Konferenca ndërkufitare për Përmirësimin e Shëndetit Riprodhues u organizua dhe moren pjesë 115 përfaqësues të institucioneve shëndetësore, OJQ-ve, autoriteteve lokale, institucioneve arsimore, mediave dhe qytetarët. Gjatë dy ditëve të konferencës ata prezantuan informacionin dhe situatën në lidhje me shëndetin riprodhues në Mal të Zi, Kosovë dhe rajon, parandalimin, diagnostikimin dhe trajtimin e kancerit të qafës së mitrës dhe kancerit të gjirit, shembuj të praktikave të mira në këtë fushë, rëndësinë e përfshirjes së të gjithë segmente të shoqërisë, etj. Për më tepër, në kuadër të projektit u organizuan 713 ekzaminime parandaluese për gratë (361 nga Mali i Zi dhe 352 nga Kosova).

Më saktësisht, 264 gra u ekzaminuan në Mal të Zi (pasi disa prej tyre bënë të dy ekzaminimet, dmth. Ekzaminim mbi Kancerin e gjirit dhe ekzaminimet parandaluese të kancerit të qafës së mitrës), nga të cilat 16% u diagnostikuan dhe kërkuan ndjekjen e kushteve të tyre shëndetësore, ekzaminime shtesë, terapi ose iu nënshtruan disa operacioneve. Në Kosovë, nga 352 gra të ekzaminuara 46% e tyre kërkuan ndjekjen e kushteve të tyre shëndetësore dhe/ose ekzaminime shtesë.



Te reja nga projektet e financuara në thirrjen e II-rë të programit IPA BNK Mal i Zi - Shqipëri

Brenda thirrjes së dytë të programit IPA BNK Mal i Zi - Shqipëri 2014-2020 u kontraktuan 7 projekte me vlerë 2.6 milion euro. Një numër i madh organizatash/institucioneve partnere aplikuan me 53 projekt – propozime për dy prioritetet tematike. Gjithashtu, 92% e fondeve të disponueshme u kontraktuan. Në zbatimin e projekteve do marrin pjesë 24 organizata/institucione partnere në të dy anët e kufirit.

Promovimi i përdorimit të qëndrueshëm të bimëve aromatike dhe medicinale për përmirësimin e jetesës dhe ruajtjen e biodiversitetit

Projekti *Promovimi i përdorimit të qëndrueshëm të bimëve aromatike dhe medicinale për përmirësimin e jetesës dhe ruajtjen e biodiversitetit* po zbatohet nga komuna Plavë, bashkia Tropojë, Qendra për Zhvillim dhe Integrim Demokratik dhe OJF Alpet Shqipëtare. Ky projekt synon të thellojë njohuritë mbi bimët medicinale dhe aromatike në zonën e projektit dhe të përcaktojë nevojat për mirë-menaxhimin e tyre.

Gjithashtu, projekti do ndërgjegjësojë banorët e zonës ndërkufitare mbi rëndësinë e bimëve medicinale dhe aromatike dhe përdorimit të qëndrueshëm në funksion të mbrotjes së biodiversitetit. Nga ana tjetër, do forcohen kapacitetet e institucioneve publike në Plavë dhe Tropojë për të siguruar monitorimin e rregullt të bimëve medicinale dhe aromatike. Grupet e synuara të projekti do jenë bujqërit e zonës,



insitucionet publike lokale, OJF aktive në mbrotjen e mjedisit dhe nxënësit nga shkollat e mesme. Ndërsa përfituesit final do jenë popullsia e bashkive/komunave të targetuara, operatorët e biznesit dhe studiuesit. Aktivitetet e projekti do zbatohen në Plavë dhe Tropojë.

Foto marrë nga: angelakatharina/shutterstock.com

Për më shumë informacion mbi projektin, klikoni [këtu](#).

Fatkeqësitë natyrore nuk njohin kufinj 2

Projekti *Fatkeqësitë natyrore nuk njohin kufinj 2* është vazhdim i angazhimit nga FORS Montenegro dhe Prefektura Shkodër në aktivitete me synim përmirësimin e mbrotjes në zonën ndërkufitare Mal i Zi – Shqipëri nga rreziku i fatkeqësive. Projekti synon të forcojë kapacitetet e institucioneve dhe shërbimeve nga zona e targetuar për reduktimin e efekteve të fatkeqësive, përmirësimin e parashikimit dhe sistemet e njoftimit të hershëm, përgatitjen e udhëzuesve për përmirësimin e mbrotjes dhe sistemet e shpëtimit në vendet përkatëse në përpunje me praktikën e mira dhe modelet e BE-së dhe të përmirësuar bashkëpunimin ndërmjet njësive dhe institucioneve kompetente në këtë fushë. Grupet e synuara janë përfaqësues nga njësitë lokale të mbrotjes dhe shpëtimit, institucionet lokale dhe kombëtare që merren me menaxhimin e emergjencave, institucionet e Hidrometrologjisë, drejtoria për menaxhimin e emergjencave, Drejtoria e përgjithshme e Shqipërisë për emergjencat civile, Instituti i Hidrometrologjisë dhe Sizmiologjisë, shkollat dhe qytetarët nga bashkitë/komunat e targetuara.



Liqeni i Shkodrës pa ndotje kimike

Projekti *Liqeni i Shkodrës pa ndotje kimike* po zbatohet nga Qendra për hulumtime toksikologjike e Malit të Zi, Universiteti I Tiranës dhe Shoqata Green Centre nga Shqipëria. Projekti synon të dakortësojë bashkëpunim në aktivitete afatgjata, të bëjë vlerësimin e rrezikut

mjedisor nga ndotjet kimike dhe të përcaktojë pikat e nxehta/kryesore të ndotjes. Gjithashtu synon rritjen e kapaciteteve të institucioneve partnere dhe ndërgjegjësimin e banorëve nga ndotjet kimike. Grupet e synuara të projektit janë institucionet kërkimore, autoritetet lokale dhe kombëtare dhe organizatat/institucione të tjera që punojnë për mbrotjen e mjedisit, ndërsa përfituesit final do jenë banorët rreth Liqenit të Shkodrës.

Takimi i parë publik/promovues i projektit u mbajt në Podgoricë me 25 shkurt të vitit 2021. Ky takim u organizua me fokus prezantimi të zbatimit të Direktivës Kuadër për Ujrat, sfidat dhe direktivat në të ardhmen. Gjithashtu pjesëmarrësit në takim kishin mundësinë të njihnin qëllimin, afatin, përgjegjësitë, ekipin dhe buxhetin e projektit.



Për më shumë informacion mbi projektin, klikoni [këtu](#).

Mali i Zi dhe Shqipëria drejt Zero Mbetjeve

Projekti *Mali i Zi dhe Shqipëria drejt Zero Mbetjeve* zbatohet nga Agjencia për Zhvillim Rajonal BKP, OJF Zero Mbetje e Malit të Zi, Fondacioni Shqipëtar për Zhvillimin e Kapaciteteve Lokale dhe OJF Green Line Shqipëri. Ky projekt synon të krijojë një platformë për të udhëzuar komunitetet lokale drejt vendeve me Zero Mbetje, t'i inkurajojë dhe mbështesë në reduktimin, riciklimin dhe ripërdorimin e mbetjeve dhe të sigurojë qëndrueshmërinë e praktikave Zero Mbetje. Projekti do zbatohet në komunën e Gucisë në Mal të Zi dhe Bashkinë Tropojë (njësia administrative Margegaj) në Shqipëri. Grupet e synuara të projektit janë popullsia lokale e Margegaj dhe Gucisë, bizneset, shkollat dhe kompanitë komunale të pastrimit. Takimi i parë i Bordit Këshillimorë për Zero Mbetje u mbajt në Guci me datë 30 prill të vitit 2021. Ky bord u krijua me synim që të përfshijë përfaqësues lokal në procesin vendimarrës gjatë zbatimit të projektit.



Për më shumë informacion mbi projektin, klikoni [këtu](#).

Punë për të rinjtë

Projekti *Punë për të rinjtë* zbatohet nga Partnerët Shqipëtarë për Ndryshim dhe Zhvillim, Shoqata për Prosperitet Demokratik – ZID e Malit të Zi dhe OJF Të Rinjtë Intelektualë – Shpresë. Projekti synon të përmirësojë aftësitë e të rinjve për të zhvilluar ide biznesi bazuar në aftësitë inovative, njohuri dhe kompetenca të reja, të rrisë mundësitë për mbështetje të bizneseve start-up për të rinjtë e përfshirë në projekt, të sipërmarrësve të rinj dhe të vetpunësuarve përmes incentivave dhe politikave lokale. Grupet e targetuara janë të rinj nga mosha 18-30 vjeç nga rajoni i Shkodrës, Podgoricës, Tuzit dhe Tivarit, si dhe organizatat lokale, insitucionet arsimore dhe bizneset private.



Të dhënat e projektit mund të shkarkohen [këtu](#).

Për më shumë informacion mbi projektin, klikoni [këtu](#).

A.C.C.E.N.T.- Aksesi, Ndërgjegjja Qytetare, Punësimi i personave me aftësi të kufizuara, si një Trend i ri

Projekti A.C.C.E.N.T.- Aksesi, Ndërgjegjja Qytetare, Punësimi i personave me aftësi të kufizuara, si një Trend i ri, po zbatohet nga Karitas i Kryepeshkopatës së Tivarit (Mal i Zi), Karitas Shqipëri, OJF Projekti Shpresë dhe Shoqata e Paraplegjikëve nga Tivari. Projekti synon të rrisë punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara (PAK) dhe të trajtojë 30 prej tyre përmes 2000 orë mentorimi, si dhe të ofrojë mundësi punësimi për PAK dhe të ndërtojë një sistem më të mirë përfshirje në nivel institucional dhe biznesi. Grupet e synuara të projektit janë personat PAK dhe aktorë të tjerë aktivë në këtë sektor në bashkitë/komunat e zonës kufitare të projektit dhe sektori i biznesit. Përfutjesit final janë anëtarët e familjeve të PAK.



Me datë 31 mars të vitit 2021 u organizua një sesion informues si pjesë e fushatës informuese të projektit ACCENT, dhe vet projekti j'u prezantua organizatave dhe institucioneve lokale në Tivar. **Marko Gjeloqi**, koordinatori nga Karitas i Kryepeshkopatës së Tivarit deklaroi se "projekti planifikon të bëj hulumtime mbi nevojat arsimore dhe mundësitë e punësimit për PAK; pas kësaj do organizohen një sërë aktivitetesh që do kontribuojnë në përmirësimin e njohurive dhe kompetencave të PAK nëpërmjet krijimit të 9 kurrikulave dhe zbatimit të trajnimeve për 120 PAK. Gjithashtu ai shtoi se 20 PAK do gjejnë/kenë mundësi të punojnë, do organizohen 2 panire punësimi për PAK dhe që 4 iniciativa vet-punësimi do mbështeten nga projekti.

Veselin Shqëpanoviq nga Zyra për Integritet Evropian mori pjesë online në takim dhe përshëndeti pjesëmarrësit. Ai deklaroi se "projektet që promovojnë punësimin japin kontribut konkret zhvillimit të zonës ndërkufitare, sidomos ato që lidhen me grupet vulnerabel në komunitete më pak të zhvilluara. Ky aspekt d.m.th fakti që përmes aktiviteteve do bëhet zhvillimi i kompetencave dhe aftësive profesionale të PAK dhe të rritet bashkëpunimi me aktorë të tjerë social, është një vlerë e shtuar e projektit.

Shihni videon nga eventin [këtu](#).



Rrugët drejt zhvillimit të karrierës (RZK): Përgatitja e të rinjve Shqiptarë dhe Malazet për mundësitë e karrierës në sektorin e turizmit

Projekti *Rrugët drejt zhvillimit të karrierës (RZK): Përgatitja e të rinjve Shqiptarë dhe Malazet për mundësitë e karrierës në sektorin e turizmit* po zbatohet nga World Vision Shqipëri, OJF Horizonti i Ri (Mal i Zi), Shkolla e mesme "Bratstvo Jedinstvo" Ulqin dhe Shkolla Profesionale "Hamdi Bushati" nga Shkodra. Projekti do të pajisë me aftësitë e duhura të rinjtë nga Shkodra dhe Ulqini në mënyrë që të jenë "gati për punë".

Si rezultat i projektit, 100 të rinj do trajnohen për aftësi teknike, kurse profesionale, si të bëjnë kërkim tregu dhe t'i lidhin këto njohuri me eksperincën dhe mundësitë e praktikave me bizneset lokale. Për më tepër, nëpërmjet projektit të rinjtë do mësojnë si të përgatisin një ide / projekt biznesi në përputhje me kërkesat e tregut dhe si rezultat 10 projekt-ide të mira do mbështeten financiarisht. Grupi i synuar i projektit janë të rinjtë nga Shkodra dhe Ulqini dhe stafet e shkollave profesionale.



Disa aktivite janë realizuar gjatë 3-mujorit të parë të vitit 2021. Inagurimi i projektit dhe takimi i parë publik u mbajt në Ulqin me datë 3 mars të vitit 2021.

Një takim tjetër u mbajt me datë 7 prill në Ulqin me përfaqësues të biznesit lokal dhe shoqatave të biznesit, gjatë të cilit pjesëmarrësit shprehën gadishmërinë e tyre për t'u përfshirë në aktivitetet për rritjen e kapaciteteve të të rinjve.



Brenda këtij projekti u organizua edhe një trajnim me 30 të rinj nga Shkodra dhe Ulqini gjatë muajit prill me fokus "Teknikat dhe metodat e kërkimit". "Më pëlqeu trajnimi, mendoj se tani kam më shumë njohuri të vazhdoj punën kërkimore bashkë me grupin" – tha Denisa (17 vjeç) nga Shkodra.



Për më shumë informacion mbi projektin, klikoni [këtu](#).

Të reja nga projektet e financuara në thirrjen e II-rë të programit IPA BNK Mal i Zi - Kosovë

Krijimi i punësimit në bujqësi

Projekti *Krijimi i punësimit në bujqësi* zbatohet nga Kryeqyteti Podgorica - Departamenti për Ndërmarrësi dhe Iniciativa për Zhvillimin e



Bujqësisë së Kosovës – IADK. Projekti synon të inkurajojë dhe përfshijë njerëzit e papunësuar për të punuar në bujqësi dhe për të forcuar

kapacitetet e tyre. Grupi i synuar i projektit janë 5000 njerëz të papunësuar në Istog, Pejë, Podgoricë dhe Tuz si dhe 50 përfaqësues të bizneseve në zonën e synuar dhe 20 zyrtarë të qeverive lokale. Partnerët e projektit promovuan përpjekjet e tyre të përbashkëta në promovimin e punësimit në bujqësi.

Për më tepër, IADK gjatë muajit maj, në mënyrë që të rrisë kapacitetin e prodhimit të fermerëve në sektorin bujqësor mbështeti 20 fermerë me grante për kultivimin e bimëve medicinale aromatike.



Brenda këtij aktiviteti, materiali fidanor u shpërnda për përfituesit e komunave të Pejës dhe Istogut, të cilët do të mbjellin 20-25 hektarë me lloje të ndryshme të bimëve vjetore dhe shumëvjeçare, siç janë: hithra, calendula, cian, mallë e zezë dhe luledielli.

Më shumë informacion mbi projektin në dispozicion [këtu](#).



PRAXIS

Projekti *PRAXIS* zbatohet nga Karitas Kosova, Karitas Mali i Zi, QAKP Gjon Nikollë Kazazi nga Gjakova dhe Komuna e Beranes. Projekti synon të mbështesë nxënësit dhe studentët dhe të rinjtë e papunësuar përmes seancave të këshillimit dhe udhëzimit në karrierë. Përmes këtij projekti, studentët dhe të rinjtë e papunësuar do të marrin trajnime të certifikuara për aftësi të buta dhe do të motivohen për të kërkuar në mënyrë aktive për një punë dhe për të pasur qasje në tregun e punës. Për më tepër, studentët dhe të rinjtë e papunësuar do të fitojnë përvojën e tyre të parë profesionale përmes një programi cilësor të praktikës dhe vullnetarizmit. Gjatë marsit të vitit 2021 gjithsej 200 pjesëmarrës nga Gjakova, Klina, Berane, Petnjica dhe Gucija u trajnuan në aftësi të buta dhe krijuese. Përveç kësaj, gjatë prillit të vitit 2021, ekipi ndërkufitar i projektit "PRAXIS", së bashku me palët e interesuara, organizuan vizitën e Parë Rajonale të Zbulimit të Punës në Maltë e Zi, duke vizituar Komunitatet e synuara të Beranës, Gucisë dhe Petnjicës. Krahas katër të rinjve të papunësuar të cilët zbuluan mjedise të reja

pune, morën informacion konkret për kushtet e punës dhe aftësitë e kërkua për punonjës të ri, katër përfaqësues të organizatave nga Komunitet e Klinës dhe Gjakovës gjithashtu u bashkuan me vizitën, duke formuar partneritetin në zonën ndërkufitare.



Qendra për Arsim dhe Këshillim Profesional "Gjon Nikollë Kazazi" nga Gjakovë nënshkroi Memorandumin e Mirëkuptimit me Shkollën e Mesme nga Petnjica. Memorandumi i Mirëkuptimit u nënshkrua gjithashtu midis Shkollës së Mesme Teknike "Fehmi Agani" nga Klina dhe Shkollës së Mesme Profesionale në Berane. Zhvillimi dhe mundësitë e përbashkëta të bashkëpunimit u planifikuan dhe konfirmuan midis Ndërmarrjes Private "TETBIT" nga Gjakova dhe Qendrës Rajonale të Biznesit në Berane, si dhe Këshillit Lokal të Veprimit të Rinisë "KVRL" nga Gjakova me Klubin e Rinisë nga Berane. Në të njëjtën kohë u mbajtën takimet Koordinuese me Znj. Anela Cekic - Kryetare e Komunitetit të Gucisë, Z. Samir Agovic - Kryetar i Komunitetit të Petnjicës dhe Menaxher i Projektit të Komunitetit të Beranës me përfaqësues Komunal të sektorit të zhvillimit ekonomik, punësimi dhe të rinjve. Gjatë takimeve u diskutuan aktivitetet e zbatuara, transparenca, dukshmëria, koordinimi dhe angazhimi i aktorëve relevantë në fushën e ndërhyrjes, si dhe strategjia për veprimet e përbashkëta të ardhshme në zonën ndërkufitare.

Më shumë informacion mbi projektin në dispozicion [këtu](#).

CARES 2 - Veprimet ndërkufitare në sektorin e shëndetit riprodhues

FORS Mali i Zi - Fondacioni për Zhvillimin e Veriut të Malit të Zi dhe ECMI Kosovë - Qendra Evropiane për Çështje të Pakicave vazhdoi me përpjekjet e tyre në sektorin shëndetësor në zonën ndërkufitare dhe që nga 1 maj 2021 po zbatojnë projektin CARES 2 - Veprimet ndërkufitare në sektorin e shëndetit riprodhues sektori 2. Projekti do të përmirësojë kapacitetin e institucioneve shëndetësore publike dhe cilësinë e shërbimeve të shëndetit riprodhues në rajonin ndërkufitar. Për më tepër, popullatës në zonën e synuar, me theks të veçantë në grupet e ndjeshme sociale, do t'u ofrohet informacioni mbi rëndësinë e mbrojtjes së shëndetit riprodhues dhe kryerjen e ekzaminimeve parandaluese.

FAST FACTS - KATUN

Katuns are temporary, farmer's settlements in the mountains, at high altitudes, where herders move their livestock to graze in the summer. The tradition of herders moving high into the mountains is a long one, and the nomadic way of life has throughout history developed a special culture and customs unique only to the katuns. At the present time this moving of livestock to katuns is practiced less and less each year, but this tradition is still maintained.

Grupet e synuara të projektit janë gratë që jetojnë në zonën e synuar dhe mjekët dhe infermierët nga institucionet shëndetësore publike në rajonin e synuar.

Më shumë informacion mbi projektin në dispozicion [këtu](#).

Qendrat e turizmit për turizëm më të mirë ofrojnë në zonat malore më pak të përparuar

Projekti Qendrat turistike për oferta më të mira turistike në zonat malore më pak të zhvilluara zbatohet nga Komuna e Andrijevicës, Komuna e Deçanit dhe Shoqata e Alpinistëve "Shkelzen Haradinaj". Gjegjësisht, përmes projektit do të krijohen nyje turizmi në Mal të Zi dhe Kosovë, do të zhvillohen produktet dhe shërbimet e turizmit veror dhe dimëror dhe zona të reja do të promovohen dhe tregtohen bashkërisht. Grupi i synuar i projektit janë gratë rurale në komunat e Andrijevica dhe Deçan, komunitetet lokale rurale në afërsi të infrastrukturës së re dhe agjencitë e turizmit që ofrojnë turizëm aktiv.



Si pjesë e aktiviteteve të projektit, një takim i përbashkët i partnerëve të projektit u mbajt në Deçan më 25 shkurt të vitit 2021. Gjatë takimit, partnerët e projektit biseduan për vazhdimin e bashkëpunimit midis komunave dhe specifikuan nevojën për vlerësim më të mirë të potencialeve të tyre natyrore. Përfaqësuesit e partnerëve të projektit theksuan nevojën për të mbrojtur burimet natyrore dhe për të promovuar turizmin, i cili përfundimisht duhet të çojë në një jetë më të mirë për qytetarët që jetojnë në zonë.

Përfaqësuesit e komunës vizituan ambientet e Shoqatës së Alpinistëve "Shkelzen Haradinaj" dhe biseduan për aktivitetet e zbatuara deri më tani në lidhje me përmirësimin e potencialeve turistike të Andrijevicës dhe Deçanit, si dhe diskutuan për lokacionin ku shtëpia e tyre malore me kapacitete akomoduese do të ndërtohet.

Më shumë informacion mbi projektin në dispozicion [këtu](#).

Transshumance - ofertë e re turistike e Kosovës dhe Malit të Zi

Transshumance - oferta e re turistike e Kosovës dhe Malit të Zi do të zbatohet nga Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës – IADK, Agjencia e Zhvillimit Rajonal Bjelasica, Komovi dhe Prokletije dhe Komuna e Istogut.

Projekti synon të mobilizojë katunët për ofrimin e shërbimeve në turizëm, të zhvillojë produkte dhe shërbime turistike dhe të promovojë vlerat kulturore, natyrore dhe bujqësore të katuneve. Grupet e synuara të projektit janë familjet në 90 katunët në zonën ndërkufitare, gratë në

katunet dhe komunitetet rurale, si dhe popullsia rurale në zonën ndërkufitare dhe turistët vendas dhe të huaj.

Një nga aktivitetet e para të projektit ishte nënshkrimi i kontrate, me 11 maj të vitit 2021, për furnizimin me panele diellore të dedikuara për mbështetjen e 50 familjeve që kanë katun në malet e komunave të Istogut dhe Pejës.



Më shumë informacion mbi projektin në dispozicion [këtu](#).

Trashëgimia kulturore - thesar i rajonit ndërkufitar

Komuna e Pejës dhe Komuna e Gucisë janë duke zbatuar projektin *Trashëgimia Kulturore - Thesari i Rajonit Ndërkufitar* që synon të mbështesë zhvillimin ekonomik të zonës së projektit që do të bazohet në vlerësimin e trashëgimisë së pasur kulturore në rajonin e synuar. Gjegjësisht, projekti synon të kontribuojë në vlerësimin e trashëgimisë kulturore në rajonin e Bjeshkëve të Nemuna duke vendosur rrugë dhe shtigje të reja kulturore, si edhe produkt dhe ofertë të re turistike në zonën e synuar. Projekti gjithashtu do të angazhojë dhe rrisë kapacitetet e njerëzve nga zonat rurale për të ofruar shërbime turistike. Grupet e synuara të projektit janë pronarët e shtëpive të vjetra, shtëpive kulla (kula), mullinjve dhe pasurive të tjera të trashëgimisë, familjet rurale përgjatë rrugëve kulturore, organizatat e turizmit dhe qeveritë lokale, si dhe operatorët turistikë në zonën e synuar.

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2021 u kryen aktivitete të shumta hulumtuese për të dokumentuar trashëgiminë kulturore të kësaj zone. Gjegjësisht, vendet, monumentet, ndërtesat, artizanët që prodhojnë produkte druri, veshje tradicionale, kapele, bizhuteri, qilima, etj., janë dëshmuar dhe në raste të caktuara artizanët e intervistuar. Ndiqni aktivitetet e projektit në faqen e dedikuar të [Facebook](#).



Për më tepër, si pjesë e aktiviteteve të projektit dhe për të lehtësuar punën e Komunës së Gucisë gjatë prillit të vitit 2021 u nënshkrua një kontratë për prokurimin e një automjeti të ri.



Më shumë informacion mbi projektin në dispozicion [këtu](#).

Ceremonia solemne me rastin e fillimit të zbatimit të projekteve të kontraktuara nga Thirrja e dytë

Ceremonia solemne me rastin e fillimit të zbatimit të projekteve të kontraktuara nga Thirrja e dytë në kuadër të Programit IPA BNK Mal i Zi – Kosovë u mbajt në Podgoricë me 26 janar të vitit 2021.



Gjatë dhënies së certifikatave përfituesve të Thirrjes së Dytë, **Zorka Kordiq**, kryenegociatore dhe koordinatore kombëtare për IPA, vuri në dukje se rëndësia e modelit të bashkëpunimit ndërkufitar konfirmohet nga rezultatet konkrete të dukshme të projekteve që janë zhvilluar deri më tani në bashkëpunim ndërmjet Malit të Zi dhe Kosovës, përmes të cilit janë vendosur baza për bashkëpunim në fushën e shkëmbimit kulturor, turizmit dhe kujdesit shëndetësor, zhvillimit ekonomik, mbrojtjes së mjedisit, përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore, kohezionit social dhe përmirësimit të mundësisë për punësim. Ajo kujtoi se me interesimin e tyre të shprehur në kuadër të Thirrjes së Dytë, organizatat dhe institucionet partnere nga Mali i Zi dhe Kosova kanë treguar gatishmëri për të kontribuar në përmirësimin e kushteve të jetesës në zonën kufitare me projektet e tyre me vlerë 2.4 milion euro.

Drejtoresha e Përgjithshme e Drejtorisë për financimin dhe kontraktimin e ndihmës së BE-së në Ministrinë e Financave dhe Mirëqenies Sociale të Malit të Zi, **Marija Vukçeviq**, shprehu gatishmërinë e plotë të Autoritetit Kontraktues për bashkëpunim me përfituesit e granteve dhe theksoi se, në bashkëpunim me partnerë nga Kosova, janë tashmë duke punuar në përgaditjen e Thirrjes së tretë e cila është planifikuar të shpallet në mars të vitit 2021, në mënyrë që t'u ofrojë të gjitha palëve të interesuara mundësinë që të bëhen përfitues të fondeve IPA në kohën e duhur.

Herman Spitz, shefi i Sektorit për Bashkëpunim në Delegacionin e Bashkimit Evropian në Mal të Zi, theksoi se përmes këtij programi të BE-së, Mali i Zi dhe Kosova përpiqen të tejkalojnë sfidat e përbashkëta në një mënyrë të qëndrueshme. "Procesi i zgjidhjes së çështjeve socio-

ekonomike në nivelin lokal është sfidues, por sjell progres afatgjatë. Është një kënaqësi e veçant për Bashkimin Evropian që të kontribuojë në këtë përparim përmes 2 milion EUR që kemi dedikuar për këtë thirrje. Ne presim që të në ardhmen do të jemi në gjendje të ndiejmë ndikimin e vërtetë që këto projekte kanë në komunitetet lokale”.



Sekretari i Përgjithshëm dhe shefi i Strukturës Operative në Ministrinë e Pushtetit Lokal të Republikës së Kosovës, Trim Berisha, njoftoi opinionin mbi vazhdimin e projekteve të bashkëpunimit brenda Thirrjes së Tretë për dërgimin e projekt-propozime, si dhe mbi gjeneratën e re të programeve që priten në kuadër të perspektivës tjetër financiare IPA III.

Përmes Thirrjes së Dytë për Propozime, të shpallur në janar të vitit 2019, fondet e Bashkimit Evropian në vlerë prej 2.017 milion EUR u ndanë për projekte të bashkëpunimit ndërkufitar, i cili, me bashkëfinancimin e përfutuesve të projektit, arrin në 2.4 milion EUR. Përmes iniciativave të tyre, përfutuesit e projekteve do të kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së jetës, duke inkurajuar punësimin dhe përfshirjen sociale, dhe përmirësimin e turizmit, trashëgimisë kulturore dhe natyrore.

Mbahen takimet dypalëshe për të dy programet

Më 27 janar të vitit 2021 në Podgoricë në hapësirat e Zyrës për Integrimet Evropiane të Malit të Zi u mbajt një takim dypalësh midis Strukturave Operative në lidhje me zbatimin e Programit IPA BNK Mali i Zi - Kosovë. Gjatë takimit u diskutua për statusin e zbatimit të Kontratës së Grantit të Asistencës Teknike (TAGC) dhe projekteve të kontraktuara brenda Thirrjes së Parë dhe të Dytë, planet për aktivitetet e ardhshme dhe ndryshimet brenda Kontratës së Grantit të Asistencës



Teknike.

Lidhur me Programin IPA BNK Mali i Zi - Shqipëri një takim dypalësh u mbajt në Podgoricë më 29 janar të vitit 2021 midis Strukturave Operative të programit. Gjatë takimit u diskutua progresi në zbatimin e projekteve të financuara brenda Thirrjes së Parë, monitorimin e projekteve dhe mbështetjen e përfutuesve, si dhe mbi aktivitetet e planifikuara për periudhën e ardhshme.

Është mbajtur mbledhja e parë e Komitetit Drejtues të Projektit për projektin e ri të asistencës teknike

Takimi i parë i Komitetit Drejtues të Projektit të asistencës teknike u organizua në 28 janar të vitit 2021 në Podgoricë. Gjatë takimit, Rregullat e Procedurave të Komitetit Drejtues të Projektit u diskutuan dhe miratuan.

Për më tepër, raporti i parë i përkohshëm narrativ i Kontratës së Grantit



të Asistencës Teknike (TAGC) "Asistenca Teknike për menaxhimin e Programeve bilaterale Ndërkufitare Mali i Zi - Shqipëri dhe Mal i Zi - Kosovë" u diskutua, rishikua dhe u miratua. Në fund, u diskutuan të gjitha çështjet e tjera në lidhje me zbatimin e të dy programeve, si dhe plani për aktivitetet e ardhshme të parashikuar në kuadër të TAGC-it.

Aktivitetet për rritjen e kapaciteteve për Aplikuesit Potencial dhe Përfutuesit e Projekteve

Gjatë muajve të parë të vitit 2021 u zbatuan një seri aktivitetesh me qëllim përfortimin e kapaciteteve për Aplikuesëve potencial dhe përfutuesëve të projekteve.



Ditët Informuese, si aktivitet promovues dhe përgatitorë para shpalljes së thirrjeve të 3-ta për dërgimin e projekt propozime në kuadër të programeve IPA BNK Mal i Zi Shqipëri dhe Mal i Zi – Kosovë 2014-2020, u organizuan gjatë muajit janar të vitit 2021 përmes online platformës MS Teams. Ditët Informuese u organizuan nga Sekretariati i Përbashkët Teknik, në bashkëpunim me Strukturat Operative të tre vendeve (Zyra për Integritet Evropian e Malit të Zi, Ministria e Financave dhe mirëqenies sociale të Malit të Zi- Drejtoria për Financimin dhe Kontraktimin e Asistencës së BE-së (CFCU), Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme të Republikës së Shqipërisë dhe Ministria e Pushtetit Lokal të Republikës së Kosovës).



Në kuadër të të dy Programeve ndërkufitare, u organizuan gjithësejt gjashtë Ditë Informuese në periudhat 11 deri me 14 janar dhe nga 19 deri me 22 janar . Në Ditët Informuese morën pjesë 135 pjesëmarrës, të cilët kishin mundësinë të parashtrojnë pyetje dhe të marrin përgjigje në lidhje me aspekte të ndryshme të këtyre dy Programeve ndërkufitare.

Gjithashtu u organizuan edhe Klinikat e Projekteve për aplikuesit e pasuksesshëm nga thirrja e 2-të e programeve IPA BNK Mal i Zi Shqipëri dhe Mal i Zi – Kosovë 2014-2020, në Podgoricë, Shkodër dhe Prishtinë. Këto takime u mbajtën gjatë muajit shkurt dhe mars të vitit 2021 dhe një total prej 18 aplikantësh diskutuan në detaje projekt propozimet e tyre me stafet e SPT-së dhe u këshilluan si t'i përmirësojnë ato.

Gjatë muajit shkurt dhe mars poashtu u organizuan edhe 4 trajnime mbi Ciklin e Menaxhimit të Projekteve për të dy programet. Qëllimi i trajnimeve ishte rritja e kapaciteteve të aplikuesve potencial për përgatitjen e projekt propozimeve. Në total 49 përfaqësues të aktorëve të interesuar morën pjesë në këto evenimente.



Me datë 15 dhe 16 shkurt të vitit 2021 u organizua seminari për zbatimin e projekteve dhe trajnimi mbi prokurimet sekondare për përfituesit e granteve nga thirrja e 2-të në kuadër të programit IPA BNK Mal i Zi

Shqipëri 2014-2020. Përfituesit e granteve patën rastin të rrisin kapacitetet e tyre në lidhje me çështjet e menaxhimit të projektit, rolit dhe përgjegjësi, dosjes së kontratës dhe anekset, menaxhimi financiarë, mbajtjen e llogarive, monitorimin, kontrollin dhe vizibilitetin, modifikimet e kontratave, parimet e prokurimeve dhe dokumentacioni përkatës, etj. Këto evenimente u organizuan nga Autoriteti Kontraktues me mbështetjen teknike të SPT.-së



Një tjetër trajnim u organizua me datë 27 prill të vitit 2021 me temë "Raportimi" dhe "Publiciteti dhe Vizibiliteti" për përfituesit e granteve nga thirrja e 2-të e programit IPA BNK Mal i Zi Shqipëri. Përfituesit e granteve patën rastin të rrisin kapacitetet e tyre në lidhje me çështjet e raportimit narrativ dhe financiarë dhe parimet bazë mbi rregullat e BE-së për vizibilitetin e projekteve.

Programi IPA BNK Mali i Zi - Shqipëri mori pjesë në Forumin EUSAIR

Gjatë Forumit të 6-të EUSAIR që u mbajt më 11 dhe 12 maj të vitit 2021, përfaqësuesit e Programit IPA BNK Mali i Zi -Shqipëri 2014-2020 morën pjesë në Panairin e Tregut Virtual dhe rrjeteve. Ngjarja u organizua në mënyrë që t'u mundësonte pjesëmarrësve të vizitonin stendat virtuale dhe të zbulonin projekte dhe programe mbi lidhjen e gjelbër, ekonominë rrethore dhe turizmin e qëndrueshëm në Euroregjionin Adriatik-Jon.

FAKTE TË SHPEJTA-EUSAIR

Strategjia e BE-së për Rajonin Adriatik-Jonian (EUSAIR) bashkon katër shtete anëtare të BE-së (Kroacia, Greqia, Italia dhe Sllovenia) dhe pesë vende aspirante (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Maqedonia Veriore dhe Serbia). Në mbledhjen vjetore të këtij viti u miratua deklarata "Izola" ku u pranua një anëtarë i ri, i dhjeti, Republika e San Marinos.



6th Forum

of the EU Strategy for the Adriatic and Ionian Region
Along the coasts of the shared sea
Izola, 11-12 May 2021



Mbahet ceremonia e hapjes së Shtëpisë për Bashkëpunim Ndërkufitar

Me 19 maj të vitit 2021 është hapur në qendër të Prishtinës "Shtëpia për Bashkëpunimin Ndërkufitar", e cila do të jetë në shërbim të komunave, organizatave të shoqërisë civile, studentëve, si dhe akterëve të ndryshëm, me qëllim të njoftimit dhe informimit të tyre lidhur me konceptin dhe idenë e funksionimit dhe zbatimit të programeve të bashkëpunimit ndërkufitar.

Z. Elbert Krasniqi, Ministër i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal theksoi se "Ndjehem i lumtur që vendet tona çdo ditë e më shumë janë duke e fuqizuar koordinimin dhe bashkëpunimin ndërshtetëror për fqinjësi të mirë, në kontekst të përmirësimit të shumë fushave të përbashkëta, duke u nisur nga aspekti i nxitjes së marrëdhënieve për zhvillim ekonomik dhe social, uljes së pabarazisë në zonat e thella ndërkufitare, zhvillimit dhe promovimit të turizmit, mbrojtjes së mjedisit, trashëgimisë kulturore dhe natyrore e deri tek sigurimi dhe lehtësimi i qasjes së qytetarëve të këtyre zonave në marrjen e shërbimeve, të cilat nxisin dhe forcojnë kohezionin social ndërmjet vendeve". Gjithashtu, Ministri Krasniqi theksoi se "Një koncept i tillë i shtëpisë së BNK-së do të shërbejë edhe si model i suksesshëm për tu aplikuar edhe tek vendet e rajonit. Ne jemi të sigurt se bashkëpunimi i mëtejshëm ndërshtetëror me ndihmën e Bashkimit Evropian, do të sjellë arritjen e rezultateve të reja, me perspektivë zhvilluese dhe sukses të garantuar".



Z. Tomáš Szunyog - Shefi i Zyrës së BE/Përfaqësues Special i BE-së, theksoi rëndësinë dhe rolin e Shtëpisë së Bashkëpunimit Ndërkufitar në Prishtinë, e cila do të shërbejë si një pikë e përbashkët koordinimi midis të gjitha Programeve IPA BNK në të cilat merr pjesë Kosova, por gjithashtu do të sigurojë qasje më të lehtë në informacion për të gjithë aplikantët e mundshëm. "Në mesin e këtyre programeve u realizuan shumë projekte dhe shumë janë në vazhdim. Përveç rezultateve, projektet e bashkëpunimit sjellin burime financiare tek autoritetet lokale, dhe përveç kësaj, ato lejojnë transferimin e njohurive dhe përvojave përtej kufijve".



Ambasadori Szunyog shpjegoi se skema e grantit për Bashkëpunim Ndërkufitar ka pasur ndikim në inkurajimin e komunikimit, rritjen e besimit dhe iniciativave ndërmjet njerëzve në rajonin ndërkufitar, duke mbështetur veprime të përbashkëta që ndërtojnë zhvillim të qëndrueshëm dhe marrëdhënie të mira fqinjësore, "thënë shkurt, këto projekte të bashkëpunimit ndërkufitar po e bëjnë jetën e përditshme të komuniteteve në secilën anë të kufijve më të mirë dhe më të lehtë. BE në Kosovë do të vazhdojë të mbështesë institucionet e Kosovës në përpjekjet e tyre në zbatimin e reformave, zhvillimin e qëndrueshëm dhe prosperitetin drejt integritet në Bashkimin Evropian".



Z. Goran Milevski - Ministër i Vetëqeverisjes Lokale të Maqedonisë së Veriut tha "Kjo Shtëpi do ofroj një gamë të gjerë të shërbimeve në një vend të vetëm për të gjithë operacionin e BNK-së në Kosovë dhe si rrjedhojë Maqedonia e Veriut si një vend partner do të përfitojë duke mbështetur aplikantët e mundshëm nga Maqedonia e Veriut në krijimin e partneritetet përtej kufirit. Bashkëpunimi dhe zhvillimi rajonal janë ndër përgjegjësitë kryesore të Ministrisë për Vetëqeverisje Lokale dhe programet ndërkufitare dhe INTERREG janë një pjesë shumë e rëndësishme e strategjisë sonë për zhvillimin rajonal."

Znj. Zorka Kordiq, Kryenegociatore dhe NIPAC Malit të Zi tha "Edhe pse veprimet e BNK-së nuk synojnë të zgjidhin sfida të mëdha sistematike dhe ekonomike, me mbështetjen e tyre për veprime pilot inovative dhe duke siguruar një platformë të hapur për shkëmbimin e njohurive, ata megjithatë vijnë dhe na udhëheqin drejt ndryshimeve, të cilat nxisin reforma dhe forcojnë institucionet tona. Sipas mendimit tim, intensifikimi i kontakteve midis institucioneve, zyrtarëve dhe stafit të Ballkanit Perëndimor, dhe si rrjedhojë bashkëpunimi i tyre i suksesshëm me Shtetet Anëtare të BE-së dhe institucionet e BE-së, është një nga arritjet më të shquara të bashkëpunimit ndërkufitar. Pikërisht për këtë jam e kënaqur që kjo iniciativë e vlefshme e Shtëpisë së BNK-së ka arritur të realizohet, si një përpjekje e bërë në drejtim të përgatitjes dhe zbatimit efikas të programeve të BNK-së."



Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë për Evropë dhe Punë të Jashtme tha "Programi i IPA për BNK Shqipëri - Kosovë përfaqëson një nga programet më të rëndësishme në të cilën Shqipëria merr pjesë. Natyra specifike e këtij programi është se kërkon përpjekje të përbashkëta për të zbatuar aktivitete të përbashkëta që synojnë përmbushjen e objektivave të programit, përparësitë dhe masat, si dhe kërkon një koordinim dhe komunikim efikas dhe në kohë nga të dy Strukturat Operative, asaj të Shqipërisë dhe Kosovës, të mbështetur nga Delegacioni i Bashkimit Evropian në Tiranë".

»» Strukturat Operuese të programit (klikoni tek ikona për të shkuar tek web - faqja)



European Integration Office



Ministry of finance
Directorate for Finance and Contracting
of the EU Assistance Funds



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Pushtetit Lokal
Ministarstvo lokalne samouprave
Ministry of Local Government



**SEKRETARIATI I PËRBASHKËT TEKNIK I IPA
PROGRAMEVE TË BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR
MALI I ZI - SHQIPËRI DHE MALI I ZI - KOSOVË 2014-2020**

Sekretariati i Përbashkët Teknik – **Zyra kryesore**
Adresa: Beogradska 17, 81 000 Podgorica, Mal i Zi
Telefon: + 382 20 240 784; + 382 20 240 631;

Sanja TODOROVIC

Drejtuuese e Sekretariatit të Përbashkët Teknik
E-mail: sanja.todorovic@jts-mne-alb-mne-kos.org

Maja RADOVIC

Zyrtare për Prokurimet dhe Financat
E-mail: maja.radovic@jts-mne-alb-mne-kos.org

Nikola DJONOVIC

Zyrtar Projekti
E-mail: nikola.djonovic@jts-mne-alb-mne-kos.org

Almir CAUSEVIC

Zyrtar Projekti
E-mail: almir.causevic@jts-mne-alb-mne-kos.org

Petar BELADA

Asistent Administrativ
E-mail: petar.belada@jts-mne-alb-mne-kos.org

Sekretariati i Përbashkët Teknik – Zyra Antenë Shkodër

Adresa: Rruga Ndoc Çoba, Nr 1 Shkodër, Shqipëri
Telefon: + 355 22 80 20 80;

Andi ÇEKAJ

Zyrtar Projekti, Antenë
E-mail: andi.cekaj@jts-mne-alb-mne-kos.org

Sekretariati i Përbashkët Teknik – Zyra Antenë Prishtinë

Adresa: Kompleksi PRIME, rruga "Tirana", Hyrja D, kati 5, Zyra nr. 53, Prishtinë, Kosovë

Gazmir RACI

Zyrtar Projekti, Antenë
E-mail: gazmir.raci@jts-mne-alb-mne-kos.org

www.cbc-mne-alb.org | www.cbc-mne-kos.org



Ky projekt është i financuar
nga Bashkimi Evropian